



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
Zyra e Kryetarit/Sektori për Financa



Nr. Prot. 02/403

Datë: 27.08.2021

Bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, NPI-01/225 për të nxjerrë në diskutim publik DRAFT BUXHETIN E KOMUNËS PËR VITIN 2022-2024, Neneve 14-21 të statutit të Komunës së Shtimes, 01 Nr.006/10911-144, datë 30. 4. 2014, Zyra e Kryetarit shpallë këtë:

NJOFTIM PËR DEBAT PUBLIK ME QYTETARË

DRAFT BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2022 - 2024

Njoftojmë qytetarët e komunës së Shtimes, se Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.08.2021, ka marrë vendim që të nxjerrë në Diskutim Publik :

DRAFT BUXHETIN E KOMUNËS PËR VITIN 2022 - 2024

Duke u bazuar në këtë vendim të Kuvendit, Zyra e Kryetarit, në bashkëpunim me Sektorin e Financave, organizojnë **Diskutimin Publik** (debat me qytetarë) sipas orarit në vazhdim:

Më datën **09.09.2021** (ditë e enjte), në ora 17:00 në Shkolla Fillore "Bajram Curri" Petrovë, për fshatrat Petrovë, Mollopoc dhe përfaqësues të lagjeve.

Më datën **09.09.2021** (ditë e enjte), në ora 18:30 në Shkolla Fillore " Hasan Prishtina" në Godanc.

Më datën **10.09.2021** (ditë e premte), në ora 17:00 në Shkolla Fillore" Lasgush Porodeci" Muzeqinë, për fshatrat: Muzeqinë, Vojnoc, Gjurkoc, Gllavicë dhe Rashincë.

Më datën **10.09.2021** (ditë e premte), në ora 18:30 në Shkolla Fillore " Abdullah Shabani" Carralevë

Më datën **10.09.2021** (ditë e premte), në ora 19:30 në Shkolla Fillore " Idriz Ajeti" në fshatin Pjetërshticë.

Më datën **14.09.2021** (ditë e marte), në Sallën e kuvendit Komunal mbahen këto takime;

Në ora 15:00 Diskutim Publik me Subjektet Politike;

Në ora 16:00 Diskutim Publik me Klubet e Biznesit;

Në ora 17:00 Diskutim Publik me Shoqërinë Civile dhe Klubet Sportive;

Në ora 18:00 Diskutim Publik me qytetarët e Shtimes (Bashkësitë I, II, III, IV, V);

Debatet Publike me Qytetarë dhe subjekte tjera do të mbahen konform rekomandimeve të IKSHP-së.

Ftojme qytetarët e Komunës së Shtimes, përfshirë edhe anëtarët e Kuvendit të Komunës, shoqërinë civile dhe të tjerët që të kontribuojnë me pjesëmarrjen e tyre në këtë debat, qoftë përmes prezencës ose E-mail: info@shtime-komuna.org

DRAFT BUXHETIN E KOMUNËS SË SHTIMES PËR VITIN 2022 - 2024, për Komunën e Shtimes mund ta shkarkoni nga uebfaqja zyrtare e komunës:

<https://kk.rks-gov.net/shtime/qarkorja-buxhetore-komunale-2022-02-komuna-shtime-draft-buxheti-2022-2024/> ose mund ta merrni si kopje fizike në Zyrën për Informim.

SHENIM MBI RREGULLAT lidhur me COVID-19

Dezinfektuesit e duarve me bazë alkooli do të jenë në dispozicion për pjesëmarrësit në hyrje të vendit ku do të mbahet debati.

Maska mbrojtëse individuale do të jenë në dispozicion për të gjithë pjesëmarrësit, të cilëve u kërkohet të mbajnë ato gjatë gjithë kohëzgjatjes së debatit.

Distanca sociale: Vendi i takimit do të organizohet për të siguruar distancën e duhur (2m) midis pjesëmarrësve, të cilëve u kërkohet me mirësi ta respektojnë atë gjatë gjithë kohës.

Kryetari i Komunës, Namik Ismaili

